

# Ruaj arsyen

Epidemitë janë pjesë e një plani hyjnor dhe janë të pashmangshme në rrjedhën e historisë. Kur njerëzit korruptohen ata krijojnë karma, sëmuren dhe pësojnë katastrofa. Në raste të tilla, njerëzit që nuk besojnë në hyjni i drejtohen “masave” të ndryshme [apo “*cuo-shi*” në gjuhën kineze] për të adresuar situatën. Por fakti që “*cuo-shi*” është një homofon për një term tjetër në gjuhën kineze që do të thotë “qasje e gabuar” është domethënës. Na janë lënë shumë mësim të vlefshme nga historia, por ato nuk merren seriozisht nga kinezët sot për shkak të mentalitetit ateist dhe mosbesimit të tyre tek hyjnorja—të dyja këto produkte të indokrinimit të trurit nga Partia Komuniste e Kinës (PKK).

Të themi të vërtetën, epidemitë vijnë kur morali dhe vlerat e njerëzve prishen dhe ata kanë krijuar sasi të mëdha karme. Kështu kur epidemia është vendosur nga hyjnitë, ç’mund të bëhet për ta ndaluar atë? Në fund të fundit është vendim hyjnor. Disa njerëz e dinë pse ndodh kjo dhe luten për mbrojtje, por me siguri kjo nuk do i ndihmojë. Për shkak se njerëzit duhet të eliminohen kur karakteri i tyre moral është prish dhe karma e tyre është bërë shumë e madhe. Pse duhet që hyjnitë t’i ofrojnë atyre mbrojtje në këtë pikë? Në vend të kësaj, ajo që njerëzit duhet të bëjnë është t’i pendohen sinqerisht perëndive, të pranojnë gabimet e tyre dhe t’i luten për një shans që të korigjojnë sjelljen e tyre. Kjo është rruga dhe kura magjike.

Por një epidemi si ajo e tanishmja e Virusit Komunist Kinez (apo “Virusi Vuhanit”) vjen për një qëllim dhe ka objektivat e tij. Ka ardhë për të eliminuar anëtarët e Partisë dhe ata që mbajnë anën e saj. Nëse nuk e besoni, thjesht hidhni një vështrim cilat vende apo njerëz janë më të goditurit nga virusi: janë ato që janë ofruar me PKK. Atëherë, çfarë duhet të bëjnë njerëzit? Njerëzit duhet të distancohen nga PKK dhe të ndalojnë së mbështeturi atë. Prapa saj qëndron demoni i kuq, ndërsa nga jashtë duket dhe vepron si cub që nuk ndalet së bëri keq. Kështu tani që hyjnitë kanë filluar ta çrrënjosin atë, të gjithë ata që akoma qëndrojnë me të do të eliminohen. Nëse nuk e besoni, thjesht prisni dhe shihni.

Edhe ata midis dishepujve të Dafës që nuk kanë qenë të zellshëm, apo që kanë tendenca për të shkuar në ekstreme, duhet të korigjojnë veten dhe të studjojnë Ligjin me sinqeritet dhe të punojnë me veten, sepse ju jeni në rrezik të madh. Dishepujt e vërtetë të Dafës kanë energji të lartë dhe janë të aftë të eliminojnë karma dhe microbe; ata janë të dërguarit e shpëtimit në këto ditë fundit dhe sjellin mençurinë e tyre për të shpëtuar njerëzit ndërsa ndajnë me ta informacionin e vërtetë mbi praktikën tonë. Gjithashtu unë dua të përmend që ka praktikues në disa rajone që u bëjnë thirrje të tjerëve të bëjnë mendime të drejta kolektive për të eliminuar Virusin Komunist Kinez (Virusin e Vuhanit"). Por kjo nuk është ide e mirë. Ju nuk jeni këtu për të ndryshuar historinë, por përkundrazi, për të shpëtuar njerëzit në kohën më të rrezikshme në histori, duke iu rritur ndërgjegjësimin, duke i bindur njerëzit të japin dorëheqjen nga tre organizatat më të mëdha komuniste në Kinë, duke i inkurajuar njerëzit të thonë me sinqeritet fjalët magjike<sup>i</sup>, e kështu me radhë. Të gjitha këto janë ilaci më i mirë i mundur, mënyra më e mirë për të shpëtuar njerëzit—kur morali i njerëzve të ndryshojë, situata do të ndryshojë për mire. PKK është në grahamat e fundit të vdekjes dhe po shkakton pandemi në botë që të dëmtojë njerëzit. Dishepujt e Dafës nuk duhet t’ja lejojnë vetes të lëkunden nga kjo. Përmbajuni parimeve themelore dhe ju do jeni në gjendje të shihni qartë përmes kaosit.

Hongzhi Li

19 mars 2020

---

<sup>i</sup> Kjo i referohet njëres nga pohimet që njerëzit recitojnë, dhe që kanë efekt magjik, në gjuhën kineze: *Falun Dafa hao* (që përkthehet "Falun Dafa është e mirë!"), dhe *Zhen, Shan, Ren hao* (që përkthehet fjalë për fjalë "Ndershmëria, Mëshirimi, dhe Durimi janë vlera të shkëlqyera.")

(Data e versionit të përkthyer 23 mars 2020)